



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

Anr.347/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Milena Deriq dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkritazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK, me seli në Prishtinë për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 08.02.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**I. PRANOHET** e bazuar ankesa e BIRN dhe Internews Anr.347/2021 e datës 05.02.2021, ndërsa subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK, me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 3,000.00 (tre mijë) euro, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, me rastin e promovimit të subjektit politik dhe kandidatit të këtij subjekti, duke e shfrytëzuar burimet e institucioneve publike – objekteve shëndetësore, me qëllim të përfimit elektoral, në fushatë zgjedhore, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen me datë 14.02.2021.

**II.** Detyrohet Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK, me seli në Prishtinë, me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi, nën kërcënim e shqiptimit të dënimit shtesë.

## A r s y e t i m

Organizata BIRN me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 05.02.2021, me të cilën pretendon se kandidatja për deputete Albena Reshitja, nga radhët e subjektit politik AAK, me datën 05.02.2021 në llogarinë e saj në facebook në postimin e saj në rrjetin social facebook, ka publikuar postimin në të cilën shihet duke i shfrytëzuar objektet publike dhe duke zhvilluar një takim publik në shtëpinë e shëndetit në Suharekë me punonjësit e kësaj qendre të QKMF me çrast e njëjta ka bërë thirrje për të votuar numrin e subjektit të saj politik dhe numrin e saj si kandidate. Parashtruesi i ankesës thekson se me këto veprime kandidatja e AAK ka shfrytëzuar objektin dhe uniformen e shërbyesve shëndetësor për qëllime të fushatës së saj politike. Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur fotot e marra nga faqja publike e kandidates në fjale ku pretendohet se ka ndodhur shkelja.

Në përgjigjen në ankesë të datës 06.02.2021, subjekti politik AAK thekson se i kandidatja në fjale nuk ka pasur për qëllim që të përfitojë nga shërbyesit publik dhe se e njëjta vetëm se është interesuar për vështirësitë dhe kushtet e mjekeve në këtë institucion për shkak të profesionit të saj si mjeke dhe si profesoreshë në fakultetin e mjekësisë, ndërsa gjatë asaj

vizite nuk ka dhënë asnjë premtim. Andaj e njëjta thekson se me tu njoftuar lidhur me ankesën e parashtruar ndaj saj, kandidatja për deputete ka ndërmarrë masa të menjëhershme për të bërë përmirësimin e shkeljes së pretenduar ashtu që ka fshirë fotografinë e publikuar në facebook. Si dëshmi të përgjigjes ka bashkangjitur foto të postimeve në faqen e saj zyrtare në Facebook në të cilat postime nuk figurojnë fotot e mëparshme ku shihej kandidatja Albena Reshitaj duke bërë fushate promovuese në QKMF në Suharekë. Subjekti politik AAK ka kërkuar nga PZAP-i që ankesa e bërë ndaj tyre nga “BIRN & Internews Kosova” të refuzohet si e pabazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

#### **Ankesa është e bazuar**

Paneli nga fotografit e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se Albena Reshitaj, kandidate për deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik AAK, ka bërë fushatë zgjedhore në QKMF në Suharekë, të cilën vizitë e ka publikuar në facebookut e saj, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 35.1 dhe 2 të LZP-së që përcakton se *personi që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë zyre ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike, ose edhe ndonjë ndërmarrje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale nuk mund të shfrytëzohen ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje. Si dhe gjate periudhës së fushatës zgjedhore asnjë subjekt politik nuk inkurajon ose përfiton nga shërbyesit publik duke përdorur pozitën publike të tij ose saj për të zhvilluar fushate për subjektin politik*

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik AAK, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Si rrethanë, Paneli e mori edhe faktin që këtij subjektit politik AAK, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e tyre të njëjtit në arsyetimin e tyre theksojnë se vizita e realizuar nuk ka pasur për qëllim të fushatës zgjedhore por duke e paraqitur si një vizitë të zakonshme, e ku pretendimet e tilla nga ana e Panelit janë të vlerësuar si të paqëndrueshme pasi që dispozita ligjore e nenit 35.1 dhe 2 e LZP-së përcakton se *asnjë institucioni i administratës publike, ose edhe ndonjë ndërmarrje nuk mund të shfrytëzohen nga ndonjë subjekt politik në zgjedhje*. Andaj Paneli gjeti se vizita e realizuar në QKMF në Suharekë nga kandidatja në fjalë ka karakter të fushatës zgjedhore të subjektit

politik në fjalë, rrethana këto të cilat kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Ndërsa si rrethane lehtësuese mori faktin se nga kandidatja në fjalë ka larguar postimin e publikuar në facebookun e saj.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik AAK, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin jo relevante dhe pa ndikim për një vendimmarrje ndryshe nga ajo që është vendos.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ 120.2 Dështimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i. ”, ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa**

Anr. 347/2021 më datën 08.02.2021



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.